

# **Drejtoria Arsmore e Filadelfias**

**Klasa e Parë, Udhëzues për Prindërit**

*Zyra e Programeve Akademike dhe Shkollore*

*Parent Study Guide for 1st Graders (Albanian)*

# Leximi/Shkrimi

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Ritregojnë një tregim sipas rendit të dëgjimit apo leximit, ku përfshihen shumë detaje të rëndësishme.
- Flasin dhe shkruajnë për ndodhitë në fillim, në mes dhe në fund të një tregimi, të cilin ata e kanë dëgjuar apo lexuar.
- Lexojnë më së paku 100 fjalë, të cilat janë më të përdorshme në shumë tregime si p.sh. read, girl, sure, etj.
- Të bëjnë parashikime, çfarë mund të ndodhë në tregimin pasardhës.
- Lexojnë me zë të lartë, në mënyrë të rrjedhëshme dhe ekspresion.
- Spellojë me korrektesë fjalët që janë më të përdorëshme.
- Shkruajnë fjali në mënyrë korrekte dhe përdorin saktë shënjat e pikësimit.



# Matematikë

## Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:

- Të dijnë të ndajnë në  $\frac{1}{2}$  dhe  $\frac{1}{4}$  e pjesëve.
- Krahasojnë numrat (më i madh, më i vogël, më shumë se, më pak se, i njejtë)
- Paraqesin të njejtin numër në mënyra të ndryshme si p.sh.  $8+2$ ,  $5+5$ , dhjetë.
- Të zgjidhin ushtrime me mbledhje dhe zbritje të numrave me një dhe dy shifra.
- Identifikojnë vlerat e monedhave metalike të ndryshme si (pennies, nickels, dimes, quarters)
- Masin gjatësinë e objekteve të ndryshme.
- Të njohin kohën në orët me shifra dhe ato tradicionale (me akrep) dhe të përcaktojnë sa kohë ka kaluar .
- Të mbledhin dhe rregjistrojnë të dhëna si p.sh. të motit.
- Të tregojnë që kuptojnë shembuj të modeleve duke thënë çfarë vjen më tej në numrat, format, ose objektet e përdorur.
- Përdorin shenjat  $+$ ,  $-$ , dhe  $=$  për të krijuar një pjesë tregimore me numra.
- Emërtojnë, vizatojnë, përshkruajnë format gjeometrike dy dimensionale si trekëndëshat, katrorët dhe drejtë-këndëshat.
- Nunërojnë me 2-sha, 5-she dhe 10-she.
- Të kuptojnë të dhjetat janë sa një të dhjetat e një numri dhe dhjetë dhjetëshe bëjnë njëqind.

# Shkencë

## **Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Të spjegojnë zbulimet e tyre duke shkruar dhe vizatuar rreth gjetjeve të tyre.
- Të grupojnë objektet e ndryshme sipas veçorive të tyre fizike: përbërja, përmasat, ngjyra etj.
- Përshkruajnë veçoritë sipas 3 gjëndjeve të materies: e ngurtë, e lëngët, e gaztë.
- Eksplorojnë ndryshimet e materies nga njëra formë në tjetrën, si duke vrojtuar një copë akulli, që kthehet nga forma e ngurtë në të lëngët.
- Vrojtojnë, përshkruajnë dhe rendisin materialet tokësore, duke u bazuar në cilësi të ndryshme.
- Përshkruajnë dhe krahasojnë disa karakteristika të bimëve dhe të kafshëve.
- Ndjekin investigime praktike për të zbuluar dhe kuptuar botën e tyre.
- Regjistrojnë vrojtimit në librin e shënimeve të shkencës.



# Studime Sociale

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Spjegojnë si individët, familjet dhe grupet kanë ngjashmëri dhe dallime.
- Kuptojnë dhe diskutojnë faktet rreth historisë Afrikanë-Amerikane.
- Njohin dhe kuptojnë konceptin e ndryshimit në mjedise të ndryshme.
- Spjegojnë ditët e ndryshme të festave dhe ditëve të veçanta, që festohen në komunitetin e tyre apo të tjerëve.
- Aplikojnë konceptet bazë ekonomike në shtëpi, shkollë dhe komunitet.
- Të njohin se si përdoret teknologjia në shtëpi, shkollë dhe në komunitet.



# Edukim Fizik/Shëndetësor

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

- Kuptojnë përbërësit e një karakteri të mirë:besueshmëria, ndershmëria, respekti, qytetaria.
- Kuptojnë ndryshimin midis ilaçeve mjekësore dhe jo mjekësore.
- Të dijnë çfarë të bëjnë për një prekje/kontakt të sigurtë dhe prekjet e rrezikëshme.
- Të bëjnë 30 minuta Edukim Fizik pa ndjerë lodhje të madhe.
- Të marrin pjesë ne lojra, ku përfshihen hedhjet dhe kapjet.

## Art dhe Muzikë

**Në fund të vitit shkollor nxënësit e klasës së parë duhet të jenë të aftë të:**

### Art

- Përdorin material të ndryshme artistike për të skicuar, pikturuar dhe bërë skulpturë.
- Të gjejnë objektin qëndror në një punë artistike si një person, shtëpi ose lule.
- Të japin opinionin e tyre për një punë artistike.

### Muzikë

- Të luajnë ritme të thjeshta për të shoqëruar këngët, vargjet dhe poezitë.
- Këndojnë ninulla dhe këngë popullore.